



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 115, Datë 10.06.2024

MBI

**DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË
KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË “MALIDO - ENERGJI” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5, 7, 9, pika dhe 5, dhe nenit 10, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.06.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1052/3 prot., datë 07.06.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqytjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “MALIDO – ENERGJI” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”

Konstatoi se:

- Shoqëria “MALIDO - ENERGJI” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Klos”, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 78, datë 23.10.2009, dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 05, datë 16.01.2012.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1052 prot., datë 08.04.2024, ajo ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj, ndërsa me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1052/1 prot., datë 09.05.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit të saj.

- Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar me shkresën nr. 1052/2 prot., datë 22.05.2024, ERE i evidentoi shoqërisë informacionin/dokumentacionin e munguar të aplikimit të saj.
- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1052/3 prot., datë 30.05.2024, shoqëria ka depozituar informacionin dhe dokumentacionin e munguar.
- Shoqëria ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021.
- Shoqëria “MALIDO - ENERGGJI” sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “MALIDO - ENERGGJI” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “MALIDO - ENERGGJI” sh.p.k.
2. Ortaku i vetëm i shoqërisë “MALIDO- ENERGGJI” shpk bëhet “AG Hpower & Construction” sh.p.k.
3. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “MALIDO - ENERGGJI” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “MALIDO - ENER GjJ” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI